U vetëdorëzua pas lokalizimit nga policia, zbardhet dëshmia e Klevis Ndrecës: Qëllova sepse pashë që kishin armë!

04 Maj, 2025 13:24

Madhësia e tekstit:

Klevis Ndreca, një nga personat e përfshirë në ngjarjen e rëndë të ndodhur në Laç mesditën e djeshme, është vetë dorëzuar pas lokalizimit nga policia ku kanë bërë kontrolle edhe me dron në zonën ku ishte fshehur.

Gazetari Igli Çelmeta raporton se në dëshminë e tij para autoriteteve, 28-vjeçari ka deklaruar se ka qëlluar me armë drejt të rinjve sepse është trembur.

"Kam qëlluar me armë drejt të rinjve sepse u tremba. I pashë që kishin armë dhe donin të më godisnin", mësohet të ketë deklaruar ai.

Ngjarja:

Pas këqyrjes së të gjithë kamerave të sigurisë në zonë dhe marrjes në pyetje të personave të përfshirë në konflikt dhe dëshmive të dëshmitarëve okularë është zbardhur e plotë e gjithë ngjarja.

I arrestuari Klevis Ndreca 28 vjeç ka qenë në makinë me Amarildo Ndojn 26 vjeç, ndërsa Daniel Gjeloshi 26 vjeç ka qenë në makinë me Liridon Ismailaj 26 vjeç dhe Gerald Bitrin 24 vjeç.

Të rinjtë janë konfliktuar verbalisht për shkak se gjatë lëvizjes me makinë kanë kapur pasqyrat e njëri-tjetrit. Konflikti verbal 5 minuta më vonë ka agravuar në përdorimin e pistoletave. 5 minuta para ngjarjes ka ndodhur konflikti për prekjen e pasqyrave të makinës dhe e kanë lënë të takohen e të sqarohen pak më tutje në rrugën ku ndodhi edhe ngjarja.

Sapo kanë ndaluar dhe zbritur të gjithë nga makinat kanë dalë në këmbë e janë afruar. Ndreca ka nisur të qëllojë me armë. Ndreca dhe Gjeloshi kanë qëlluar me armë në drejtim të njëri-tjetrit. Klevis Ndreca ka qëlluar me armë drejt tre të rinjve të tjerë të cilët i la të plagosur (sot në spital ndërroi jetë Gerald Bitri), nga të shtënat me armë i plagosur aksidentalisht mbeti edhe shoku i tij Amarildo Ndoj dhe shitësja ambulante.

Me armë zjarri pistoletë është kundërpërgjigjur edhe Daniel Gjeloshi por nuk ka plagosur asnjë person. Arma që u gjet pak metra larg vendit të ngjarjes i përket 26-vjeçarit Daniel Gjeloshi. Klevis Ndreca pas ngjarjes është larguar në këmbë.

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

TË NGJASHME

VIDEO/ Vllaznia e madhe në "Arenën Kombëtare", i tregon forcën Dinamos dhe shkon në finalen e "Final Four"
04 Maj, 2025

"Ju kërkoj falje, nuk dua të bëhem barrë", 58-vjeçari i jep fund jetës në banesë, lë pas letrën e dhimbshme të lamtumirës
04 Maj, 2025

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

Aksident në aksin Shkodër-Lezhë, makina përplas motomjetin, dy adoleshentët përfundojnë në spital
04 Maj, 2025

Gjendet pa jetë një person pranë portit të Shëngjinit, policia dyshon se është një 37-vjeçar nga Fushë-Kruja
04 Maj, 2025

Ishin për turizëm në Sarandë, aksidentohen me motor dy të rinjtë 21-vjeçarë. Drejtuesi i motomjetit është shtetas italian
04 Maj, 2025

Policia e Fierit bën bilancin e muajit të fundit: Në pranga 617 autorë, janë goditur 3 grupe kriminale
04 Maj, 2025

Përfshihet nga flakët një pallat në Radhimë, evakuohen banorët
04 Maj, 2025

U plagos në masakrën e Laçit/ Ndërroi jetë sot te Trauma, del foto e Gerald Bitrit. I riu u qëllua disa herë me pistoletë
04 Maj, 2025

KATEGORIA VIDEO

VIDEO/ Vllaznia e madhe në "Arenën Kombëtare", i tregon forcën Dinamos dhe shkon në finalen e "Final Four"
04 Maj, 2025

VIDEO/ Nuk ka dramë te Tirana, bardhebluta sigurojnë qëndrimin në Superiore, mundin Pogradecin
04 Maj, 2025

VIDEO/ United bie sërish, Brentford feston ndaj "Djajve të Kuq"
04 Maj, 2025

VIDEO/ Reali vijon ndjekjen ndaj Barcelonës, kalon pengesën e Celta Vigos
04 Maj, 2025

VIDEO/ Vrioni protagonist, gjen golin në MLS
04 Maj, 2025

VIDEO/ Lazio triumfon ndaj Empolit, Hysaj dhuron asist dhe më pas ndëshkohet me të kuq
04 Maj, 2025

LAJMET E FUNDIT

VIDEO/ Vllaznia e madhe në "Arenën Kombëtare", i tregon forcën Dinamos dhe shkon në finalen e "Final Four"
04 Maj, 2025

VIDEO/ Nuk ka dramë te Tirana, bardhebluta sigurojnë qëndrimin në Superiore, mundin Pogradecin
04 Maj, 2025

VIDEO/ United bie sërish, Brentford feston ndaj "Djajve të Kuq"
04 Maj, 2025

VIDEO/ Reali vijon ndjekjen ndaj Barcelonës, kalon pengesën e Celta Vigos
04 Maj, 2025

VIDEO/ Vrioni protagonist, gjen golin në MLS
04 Maj, 2025

VIDEO/ Lazio triumfon ndaj Empolit, Hysaj dhuron asist dhe më pas ndëshkohet me të kuq
04 Maj, 2025

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb

© 2025 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.